



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5

Pristina

Tel: +381 (0) 38 249-918

Fax: +381 (0) 38 249-919

E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT.: KPCC/D/A/92/2010

DATA E VENDIMIT: 28/10/2010

URDHËR

(1) Në secilën prej 926 (nëntëqind e njëzetegjashtë) kërkesave të identifikuar në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) Në secilën prej 285 (dyqindetëdhjetë e pesë) kërkesave të identifikuar në pjesën E të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar pronësinë e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(3) Në secilën prej 1,211 (njëmijë e dyqind e njëmbëdhjetë) kërkesave të përmendura në paragrafët (1) dhe (2) më sipër, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(b) Çdo person i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse çdo person që ka uzurpuar pronën i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;

(4) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të refuzohen për aq sa paraqitësi i kërkesës kërkon kompensim për dëmin material, apo humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar; dhe.

(5) Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit nga bashkë-pronarët përkatës.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili miraton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores të UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposeditim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka

ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të nxjerrë urdhër për riposëdimit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e tij të nëntëmbëdhjetë prej 26 deri më 28 tetorit 2010 në Prishtinë. Gjithsej 1241 kërkesa për pronë bujqësore i janë paraqitur Komisionit në seancën e tij të nëntëmbëdhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Komisioni gjithashtu ka finalizuar vendimin për 2 kërkesat të cilat i ishin paraqitur nga Sekretaria Ekzekutive në seancën e tij të trembëdhjetë, por që Komisioni kishte pezulluar shqyrtimin e tyre në pritje të konfirmimit të notifikimit të kërkesave për pronat e kërkuara. Gjithsej, 1243 kërkesa për pronë bujqësore u shqyrtuan nga Komisioni gjatë seancës së nëntëmbëdhjetë.

6. Gjithsej 318 nga 1243 kërkesat e paraqitura Komisionit në seancën e tij të nëntëmbëdhjetë nuk ishin shqyrtuar më herët nga Komisioni, ndonëse 925 prej kërkesave kanë qenë subjekt i vendimit të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimet e mëparshme për këto kërkesa ishin shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë procesit të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara e duke marrë në konsideratë informacionin e ofruar nga palët përgjegjëse të kërkesave apo nga uzurpuesit aktual të pronave. Në kërkesat për të cilat vendimet e mëparshme janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria i ka shkruar secilit paraqitës të kërkesës duke iu treguar atyre për gabimin e notifikimit dhe duke i informuar ata se kërkesat e tyre do të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Paraqitësit e kërkesave si dhe autoritetet kadastrale përkatëse janë informuar se vendimet e

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislativë dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

mëparshme te Komisionit janë të pavlefshme dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e ndonjë transaksioni ligjor.

7. Në seancën e nëntëmbëdhjetë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuere të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi.

8. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

9. Vendimi aktual trajton 1211 kërkesat për pronë bujqësore të regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur. Pjesa e mbetur prej 32 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga komisioni gjatë seancës, përfshihen në dy vendimet e tjera, pikërisht vendimin KPCC/D/A/93/2010 dhe vendimin KPCC/D/A/94/2010.

10. Komisioni vëren se të gjitha kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Nëntë qind e njëzet e pesë kërkesat e përfshira në këtë vendim kanë të bëjnë me kërkesa të cilat fillimisht u notifikuan në mënyrë të pasaktë nga Sekretaria Ekzekutive dhe vendimet e të cilave u morën nga Komisioni duke u bazuar në këto notifikime. Vendimet e marra për këto kërkesa janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë e për t'i siguruar cilitdo personi i cili mund të ketë interes ligjor për pronën, mundësinë për t'iu përgjigjur kërkesës në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur vendimit. Sekretaria Ekzekutive ka njoftuar për kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen si jokontestuese.

11. Në kërkesat e përmendura në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur, Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të

dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, përfshirë fletët poseduese, kontratat e shitblerjes, kontratat e dhurimit, kontratat për ndarjen e pasurisë, vendimet për trashëgiminë, vendimet e gjykatës për njohjen e pronësisë, kontratat për përkujdesjen jetësore dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme. Komisioni është i kënaqur se vendimet e gjykatës së formës së prerë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme që konfirmojnë interesin pronësor me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Dokumentet e tjera të dorëzuara nga paraqitësit e kërkesave përfshirë fletët poseduese dhe kontratat që përfshijnë transaksione pronësore krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të së drejtës pronësore. Kërkesat e përfshira në këtë vendim janë jokontestuese edhe nuk është marrë ose nuk është kërkuar *ex officio* nga Sekretaria asnjë prove që do të kundërshtonte supozimin e të drejtës pronësore. Rrjedhimisht, Komisioni është i kënaqur me faktin se dokumentet e dorëzuara provojnë të drejtën pronësore të paraqitësve të kërkesave për pronat e kërkuara. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe konsiderohen si relevante. Shumë paraqitës të kërkesave kanë paraqitur gjithashtu dokumente mbështetëse shtesë, përfshirë vendimet për tatimin, deklaratat e dëshmitarëve, kopjet e planeve dhe vendimeve kadastrale.

12. Në 561 kërkesat e identifikuara në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në bazë të konstatimeve të Komisionit në paragrafin 11 më sipër, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen. Në kërkesat nr. 15474 & 15434, Komisioni vëren se, ndonëse të dy kërkesat ndërlidhen me të njëjtën pronë, paraqitësit e kërkesave kërkojnë vetëm për pjesët e tyre respektive të pronës në mënyrë që dy kërkesat të mos mbivendosen. Komisioni është i kënaqur që secili nga paraqitësit e kërkesave ka dëshmuar pronësinë për pjesët respektive të pronës së kërkuar në ato pjesë ashtu si përcaktohet në vendimet përkatëse individuale.

13. Në 231 kërkesat e identifikuara në pjesën B të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhërësës Administrative i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky përkufizim përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave në kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur përfshihen në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në secilën kërkesë të regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e regjistruara në kolonën përkatëse të pjesës B të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës pohon se bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur por nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të dokumentuar e cila do të dëshmonte vdekjen, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të

bartësit të së drejtës pronësore gjithashtu duhet të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër.

14. Në 15 kërkesat e përfshira në pjesën C të listës së bashkëngjitur, bartësi i së drejtës pronësore përfaqësohet nga një person fizik i autorizuar. Komisioni ka vendosur që individi i autorizuar posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit në bazë të nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, duhet të miratohet vendimi për konfirmimin e të drejtës pronësore në dobi të bartësit të së drejtës pronësore në lidhje me këto kërkesa. Në kërkesën nr. 28262, personit i cili ka depozituar kërkesën, i është lëshuar autorizim nga bartësi i së drejtës pronësore edhe pse ajo është motra e bartësit të së drejtës pronësore dhe kështu mund të kishte depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare. Komisioni konsideron se autorizimi është një prokurë me specifike dhe rrjedhimisht kërkesa duhet të konsiderohet sikur është depozituar nga bartësi i autorizimit se sa nga anëtari i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore.

15. Në 119 kërkesat e përmendura në pjesën D të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk ka qenë bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por ka ofruar dëshmi se më pas e ka trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë përmes trashëgimisë, kontratës së dhurimit apo kontratës së shitblerjes, siç mund të jetë rasti. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, duhet të konsiderohet si person i cili ka trashëguar të gjitha të drejtat të cilat i takojnë një pronari, qoftë si bashkëpronar ose pronar i vetëm i pronës në bazë të dokumentit të verifikuar që provon trashëgiminë e tillë e përcaktuar në pjesën ideale të pronës së kërkuar, përfshirë të drejtën për të kërkuar konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin në këtë procedim. Prandaj këto kërkesa duhet të aprovohen, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e përmendura në kolonën përkatëse të kësaj pjese D të listës së bashkëngjitur, kërkesat janë paraqitur ose nga anëtari i bashkësisë familjare ose nga përfaqësuesi i autorizuar që vepron në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Komisioni përcakton se paraqitësit e kërkesave në këto raste janë ose anëtarë të bashkësisë familjare të bartësit aktual të së drejtës pronësore në kuptim të nenit 1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 ose janë bartës aktualë të së drejtës pronësore që kanë përfaqësues të autorizuar të cilët posedojnë autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit në bazë të nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, për të paraqitur kërkesë në emër të tyre. Në kërkesat me nr. 06582, 06583, 06585, 06586, 06587, 06588, 06589, 06590, 06591, 06593, 06598 dhe 06599, fillimisht kërkesat janë paraqitur nga kushëriri i bartësit aktual të së drejtës pronësore si paraqitës të kërkesës. Meqë paraqitësi i kërkesës nuk është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, atij iu kërkua të ofrojë autorizimin për përfaqësimin e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës i tregoi Sekretarisë Ekzekutive se ai nuk dëshironte të dorëzonte autorizim dhe nuk dëshironte të kontaktohej më për kërkesën. Po ashtu ai nuk dëshiron të tërheqë kërkesat. Në këto rrethana, Sekretaria Ekzekutive kontaktoi drejtpërsëdrejti bartësin e së drejtës pronësore i cili informoi se ai dëshironte të vazhdonte me kërkesën në të drejtën e tij. Pasi bartësi aktual i së drejtës pronësore ishte pronar i pronës në kohën e paraqitjes së kërkesës në vitin 2007 dhe pasi kërkesat janë paraqitur në emër të tij, Komisioni konsideron se ai ka zotësinë e kërkuar të vazhdojë me kërkesat në emër të tij. Në

kërkesën nr. 27360, personit i cili ka depozituar kërkesën i është dhënë autorizim nga bartësi i së drejtës pronësore edhe pse ai është djali i bartësit të së drejtës pronësore dhe do të kishte qenë në pozitën për te depozituar kërkesë si anëtar i bashkësisë familjare. Komisioni konsideron se autorizimi është prokurë -më specifike dhe rrjedhimisht kërkesa duhet të konsiderohet sikur të jetë depozituar nga mbajtësi i autorizimit se sa nga anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore.

16. Në 285 kërkesat e përmendura në pjesën E të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të ketë trashëguar pronën. Në secilën nga këto kërkesa paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se ai apo ajo është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur vendim i vlefshëm për trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuar nga paraqitësit e kërkesave, i cili do të vërtetonte që ndonjëri nga paraqitësit e kërkesave të jetë trashëgimtar i pronës së kërkuar, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Disa paraqitës të kërkesave kanë paraqitur si prova “vendime të trashëgimisë” të lëshuara posaçërisht nga gjykatat paralele në Serbi. Komisioni nuk konsideron që dokumentet e tilla mund të vërtetojnë të drejtën e trashëgimisë. Komisioni nuk ka juridiksion të zgjidhë çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër. Vendimi i Komisionit sa i përket të gjitha kërkesave të përmendura në këtë pjesë E të listës së bashkëngjitur, nuk cenon vendimin e gjykatave kompetente për mënyrën se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Në kërkesat e regjistruara në kolonën përkatëse të kësaj pjese E të listës së bashkëngjitur, anëtar i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore është përfaqësuar nga personi fizik i autorizuar me autorizim. Komisioni ka përcaktuar se në secilin nga këto raste personi i autorizuar fizik posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga anëtar i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore sipas nenit 5.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, duhet të aprovohet vendim për konfirmimin e së drejtës pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore në secilën nga këto raste. Në kërkesën nr. 34744 Komisioni vëren se mbi pronën ndodhet një mulli me sipërfaqe prej 12 m². Paraqitësi i kërkesës informon se mulliri shfrytëzohet për qëllime personale e jo komerciale dhe rrjedhimisht Komisioni konsideron se kërkesa ka të bëjë me pronë bujqësore.

17. Llojet e ndryshme të dokumenteve në të cilat janë mbështetur paraqitësit e kërkesave në përkrahje të kërkesave të cekura në paragrafët 12 deri 16 të mësipërm janë të regjistruara në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur.

18. Në një numër kërkesash, paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, janë larguar nga prona jashtë periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999, e cila parashihet në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar që, ndonëse data e largimit në këto kërkesa është jashtë periudhës së mësipërme, humbja e së drejtës pronësore në secilin rast është rezultat i rrethanave që ndërlikohen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998

dhe 20 qershorit 1999, siç kërkohet me nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

19. Në disa kërkesa, paraqitësi i kërkesës ka vdekur pas paraqitjes së kërkesës. Komisioni konsideron që vdekja e paraqitësit të kërkesës gjatë procedurës nuk mund të ndikojë në vlefshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore duhet të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Ky vendim nuk cenon vendimin e gjykatave kompetente për mënyrën si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri.

20. Nga sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon se:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është jokontestuese në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

B. Kërkesat për kompensim.

21. Në kërkesat e përmendura në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

C. Vërejtjet përmbledhëse.

22. Nga sa u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe urdhri sa i përket secilës kërkesë, të jepet siç është dhënë më sipër.

23. Në një numër kërkesash, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për riposëdim të pronës së njëjtë në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore, e cila kërkesë më pastaj është aprovuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC"). Komisioni konstaton se mjetet e veprimit në dispozicion të paraqitësve të kërkesave para Komisionit aktual dhe HPCC-së, respektivisht, dhe, rrjedhimisht edhe juridiksioni i dy Komisioneve, nuk janë të njëjta në kuptimin se, ndryshe nga HPCC-ja, Komisioni aktual

ka juridiksion për të konfirmuar pronësinë. Rrjedhimisht, vendimet e HPCC-së nuk përbëjnë *res judicata* para Komisionit aktual. Për më tepër, në rastet kur HPCC-ja ka aprovuar urdhrin për dëbim në favor të Paraqitësit të kërkesës, Komisioni nuk konsideron se një urdhër i tillë paraqet pengesë për këtë Komision që të lëshojë urdhër të ri për dëbim në rastet kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

24. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

25. Në bazë të nenit 8.5 të aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mundet të vendosi në vendimin e tij për të drejtën pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore edhe të nxjerrë urdhër për posedimin në dobi të paraqitësit të kërkesës. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore është i gjallë, Komisioni miraton të drejtën e posedimit në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur e vdekja është provuar por nuk është siguruar vendim i vlefshëm për trashëgiminë, Komisioni miraton posedimin për paraqitësin e kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore. E drejta e posedimit miratohet në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi që rregullon marrëdhëniet familjare në Kosovë, i cili përfshin administrimin e pronës familjare si dhe duke iu referuar ligjit në fuqi për trashëgiminë. Vendimi i Komisionit për të drejtën e posedimit të pronës nga paraqitësi i kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare nuk cenon të drejtën e anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, ose trashëgimtarëve të tjerë, të bartësit të së drejtës pronësore të cilët nuk kanë depozituar kërkesë në KPA, por të cilët mund të kenë të drejtë të përbashkët për posedimin e pronës në bazë të ligjit në fuqi ose si rrjedhojë e procedimit për trashëgiminë në të ardhmen. (neni 8.5 i aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079).

26. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA14034	KPA14545	KPA14554	KPA25629	KPA26025	KPA26026	KPA38152
KPA44441	KPA47040	KPA47041	KPA47044	KPA47045	KPA47046	KPA48214
KPA48419	KPA48423	KPA48429	KPA50157	KPA52396	KPA56721	KPA24495
KPA38054	KPA41480	KPA41481	KPA49093	KPA52656	KPA56322	KPA56323
KPA56331	KPA56714	KPA56719	KPA56722	KPA56724	KPA56725	KPA90728
KPA90729	KPA90730	KPA90731	KPA90732	KPA90733	KPA15460	KPA15472
KPA18246	KPA36259	KPA42441	KPA42446	KPA42447	KPA42448	KPA56328
KPA56720	KPA90720	KPA90721	KPA90722	KPA90723	KPA90724	KPA90725
KPA90726	KPA90727	KPA90763	KPA43320	KPA43321	KPA43322	KPA43324
KPA47763	KPA47765	KPA47767	KPA47768	KPA47769	KPA47771	KPA47772
KPA47773	KPA47774	KPA47775	KPA47776	KPA47778	KPA56330	KPA08160
KPA08168	KPA08254	KPA07259	KPA07285	KPA07286	KPA21524	KPA21525
KPA21527	KPA21528	KPA21529	KPA21530	KPA21531	KPA21533	KPA21534
KPA21535	KPA29927	KPA29929	KPA29930	KPA29932	KPA29933	KPA29935
KPA29938	KPA07251	KPA07257	KPA07267	KPA07271	KPA07274	KPA07278
KPA07280	KPA07291	KPA07299	KPA07301	KPA07304	KPA07305	KPA07308
KPA07309	KPA07311	KPA21526	KPA21532	KPA21536	KPA24271	KPA29934
KPA07266	KPA07272	KPA07276	KPA07334	KPA07337	KPA14047	KPA14048
KPA24080	KPA24087	KPA24088	KPA28403	KPA33029	KPA33031	KPA33032
KPA33033	KPA33035	KPA40235	KPA40240	KPA40243	KPA06514	KPA18020
KPA18024	KPA18323	KPA28402	KPA27747	KPA27791	KPA27798	KPA06364
KPA46192	KPA54981	KPA07277	KPA00117	KPA00118	KPA00119	KPA00095
KPA35484	KPA13736	KPA13737	KPA13738	KPA13741	KPA13742	KPA13745
KPA00090	KPA00116	KPA35485	KPA23038	KPA35371	KPA18316	KPA18313
KPA35488	KPA35487	KPA36102	KPA36097	KPA23041	KPA23045	KPA23044
KPA23042	KPA23040	KPA23039	KPA36101	KPA36103	KPA36105	KPA36106
KPA36107	KPA36096	KPA37332	KPA19357	KPA01004	KPA01007	KPA15511
KPA15507	KPA33503	KPA33508	KPA33504	KPA33485	KPA22154	KPA33502
KPA33505	KPA33487	KPA33497	KPA33122	KPA23953	KPA23965	KPA26010
KPA25018	KPA26007	KPA23961	KPA23971	KPA33116	KPA35197	KPA36457
KPA36444	KPA26013	KPA21039	KPA19187	KPA19172	KPA19097	KPA18388
KPA18319	KPA23968	KPA26008	KPA36453	KPA40036	KPA40041	KPA39537
KPA39538	KPA39551	KPA39548	KPA39547	KPA39552	KPA39553	KPA39555
KPA39558	KPA39559	KPA39563	KPA40038	KPA40039	KPA19182	KPA19177
KPA33501	KPA22077	KPA27471	KPA27469	KPA27467	KPA27463	KPA27474
KPA40306	KPA40301	KPA40498	KPA40500	KPA40381	KPA36823	KPA36104
KPA36121	KPA36099	KPA15866	KPA15999	KPA15996	KPA25159	KPA00630
KPA07288	KPA18363	KPA25817	KPA40499	KPA40393	KPA40390	KPA40308
KPA24098	KPA19189	KPA19188	KPA24125	KPA24107	KPA24129	KPA24128
KPA24138	KPA24096	KPA18131	KPA18132	KPA18138	KPA19056	KPA19058

KPA19055	KPA15867	KPA18364	KPA19175	KPA19173	KPA19178	KPA19179
KPA19181	KPA24139	KPA24136	KPA24101	KPA07336	KPA07328	KPA07325
KPA07323	KPA07298	KPA07287	KPA15175	KPA15503	KPA15499	KPA15500
KPA15502	KPA08305	KPA23006	KPA23005	KPA08300	KPA29703	KPA29705
KPA08755	KPA11201	KPA11202	KPA11475	KPA11429	KPA40417	KPA40412
KPA40408	KPA40272	KPA40270	KPA40266	KPA40265	KPA40263	KPA11368
KPA11367	KPA40416	KPA18387	kPA18385	KPA18378	KPA18377	KPA15467
KPA15468	KPA15471	KPA15474	KPA15455	KPA15434	KPA15427	KPA15423
KPA22029	KPA22031	KPA22028	KPA22030	KPA24376	KPA24383	KPA24410
KPA06520	KPA06519	KPA06517	KPA22027	KPA24386	KPA24372	KPA24379
KPA21308	KPA21307	KPA21305	KPA24085	KPA24089	KPA24090	KPA24083
KPA06521	KPA06523	KPA06524	KPA18369	KPA17877	KPA18249	KPA06526
KPA06527	KPA18324	KPA20092	KPA20090	KPA20095	KPA18247	KPA15506
KPA23970	KPA20094	KPA24373	KPA24382	KPA24389	KPA21310	KPA21309
KPA15509	KPA15505	KPA34545	KPA34544	KPA34543	KPA34542	KPA34541
KPA34540	KPA34539	KPA34538	KPA34537	KPA34535	KPA34533	KPA34532
KPA34531	KPA34530	KPA34529	KPA18021	KPA18017	KPA18014	KPA23960
KPA23963	KPA22038	KPA22039	KPA25021	KPA25016	KPA26011	KPA33024
KPA31111	KPA40497	KPA27514	KPA23974	KPA23977	KPA23955	KPA23956
KPA23957	KPA23959	KPA25022	KPA26439	KPA26440	KPA26441	KPA26442
KPA26004	KPA26444	KPA31317	KPA01181	KPA13739	KPA31112	KPA31327
KPA31323	KPA31322	KPA31321	KPA31319	KPA31334	KPA31333	KPA31331
KPA31330	KPA31328	KPA14559	KPA22032	KPA22033	KPA22504	KPA31096
KPA31097	KPA31099	KPA32280	KPA07420	KPA19053	KPA28493	KPA16228
KPA40232	KPA40231	KPA40222	KPA06291	KPA06284	KPA06281	KPA16229
KPA16230	KPA26446	KPA33782	KPA33781	KPA00408	KPA06409	KPA08214
KPA08217	KPA08212	KPA08209	KPA21145	KPA21146	KPA21149	KPA21148
KPA21150	KPA21143	KPA21142	KPA21139	KPA19400	KPA19402	KPA19403
KPA19404	KPA15930	KPA19405	KPA19406	KPA19407	KPA18265	KPA18266
KPA16247	KPA38276	KPA38275	KPA38273	KPA38272	KPA38271	KPA38270
KPA38266	KPA38265	KPA38262	KPA38260	KPA38259	KPA13233	KPA13231
KPA10127	KPA14375	KPA14374	KPA14373	KPA14372	KPA14371	KPA14383
KPA14382	KPA14381	KPA14379	KPA14378	KPA14376	KPA14369	KPA14368
KPA14367	KPA14370	KPA14377	KPA11171	KPA11170	KPA08303	KPA08250
KPA13303	KPA24081	KPA40244	KPA40238	KPA24082	KPA40224	KPA24078
KPA19408	KPA19409	KPA07145	KPA07293	KPA07306	KPA07290	KPA07284
KPA07268	KPA15933	KPA15931	KPA15928	KPA15927	KPA15124	KPA11177
KPA13735	KPA18136	KPA21207	KPA16483	KPA16485	KPA16487	KPA16486
KPA18254	KPA18251	KPA18256	KPA13195	KPA06310	KPA06321	KPA06275
KPA07921	KPA07931	KPA07252	KPA21199	KPA21200	KPA21201	KPA21203
KPA16290						

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA08491	KPA08493	KPA08497	KPA08499	KPA08500	KPA22698	KPA28237
KPA28239	KPA38717	KPA39363	KPA39369	KPA39370	KPA40934	KPA41196
KPA44572	KPA47779	KPA51701	KPA53846	KPA53848	KPA54228	KPA08490
KPA08501	KPA15554	KPA26257	KPA26645	KPA27458	KPA28610	KPA29138
KPA29139	KPA39239	KPA39240	KPA39241	KPA39322	KPA39360	KPA40513
KPA42222	KPA44795	KPA52638	KPA52644	KPA91002	KPA23329	KPA26256
KPA26646	KPA28230	KPA28231	KPA28241	KPA41494	KPA15075	KPA17929
KPA31313	KPA31315	KPA34425	KPA39323	KPA48627	KPA48632	KPA50300
KPA50364	KPA50830	KPA53964	KPA53965	KPA53966	KPA54208	KPA91228
KPA90406	KPA48603	KPA48604	KPA48605	KPA48606	KPA48607	KPA48608
KPA48609	KPA48611	KPA48612	KPA48613	KPA48614	KPA48615	KPA48616
KPA48617	KPA32457	KPA32458	KPA32459	KPA32466	KPA32469	KPA08297
KPA08298	KPA08299	KPA10202	KPA10209	KPA06201	KPA06203	KPA36898
KPA36897	KPA36892	KPA36915	KPA36891	KPA36896	KPA36895	KPA36893
KPA36894	KPA36909	KPA36912	KPA36900	KPA31460	KPA31467	KPA31466
KPA31465	KPA31464	KPA36914	KPA31450	KPA08304	KPA08301	KPA31458
KPA31462	KPA06765	KPA31457	KPA31456	KPA31452	KPA31451	KPA06773
KPA06780	KPA06789	KPA06762	KPA36899	KPA07614	KPA31459	KPA31454
KPA31453	KPA31463	KPA06791	KPA06790	KPA06763	KPA17045	KPA00417
KPA00421	KPA29817	KPA44065	KPA36332	KPA17064	KPA06545	KPA06546
KPA06539	KPA07632	KPA07621	KPA07590	KPA07606	KPA07599	KPA07597
KPA07603	KPA26271	KPA44695	KPA44688	KPA44684	KPA44683	KPA44694
KPA44693	KPA36328	KPA07641	KPA07637	KPA07635	KPA07615	KPA07613
KPA07611	KPA17058	KPA17059	KPA17060	KPA17063	KPA00420	KPA44691
KPA44689	KPA44687	KPA17055	KPA17056	KPA17057	KPA36688	KPA36680
KPA36687	KPA06230	KPA26124	KPA26122	KPA26128	KPA36689	KPA28178
KPA06177	KPA06172	KPA27016	KPA27018	KPA19217	KPA26127	KPA36677
KPA07605	KPA07608	KPA07609	KPA07588	KPA07602	KPA07589	KPA07594
KPA07595	KPA07586	KPA07581	KPA07582	KPA07587	KPA13339	KPA13340
KPA13866	KPA24067	KPA44564	KPA44563	KPA10201	KPA10195	KPA13865
KPA13864	KPA07627	KPA07623	KPA07617	KPA07620	KPA08760	KPA10068
KPA08758	KPA11087	KPA11088	KPA06200	KPA06202	KPA06195	KPA06198
KPA06204	KPA14444	KPA08422	KPA08429	KPA14446	KPA14443	KPA16295

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA28262	KPA00414	KPA00415	KPA00416	KPA36582	KPA36584	KPA36586
KPA36587	KPA36588	KPA36589	KPA36590	KPA36592	KPA36593	KPA38558
KPA38561						

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA06582	KPA06583	KPA06585	KPA06586	KPA06587	KPA06588	KPA06589
KPA06590	KPA06591	KPA06593	KPA06598	KPA06599	KPA13456	KPA13528
KPA21656	KPA31630	KPA36397	KPA52036	KPA52193	KPA56674	KPA41259
KPA41262	KPA41264	KPA41265	KPA41266	KPA16155	KPA27360	KPA55176
KPA55185	KPA25384	KPA25388	KPA14822	KPA06863	KPA06017	KPA31626
KPA06006	KPA33506	KPA33493	KPA00097	KPA08420	KPA08418	KPA21034
KPA23909	KPA24117	KPA24135	KPA08406	KPA00797	KPA21046	KPA08404
KPA19176	KPA19170	KPA35918	KPA13934	KPA08216	KPA08220	KPA08218
KPA08219	KPA13035	KPA06632	KPA21042	KPA14818	KPA15428	KPA15473
KPA07934	KPA35870	KPA07630	KPA19184	KPA19174	KPA08222	KPA08221
KPA08417	KPA08416	KPA08407	KPA08409	KPA06702	KPA19087	KPA19091
KPA19092	KPA19093	KPA19096	KPA25670	KPA19127	KPA16399	KPA13241
KPA06116	KPA06103	KPA06115	KPA06026	KPA06008	KPA15292	KPA06027
KPA32272	KPA24411	KPA31068	KPA08415	KPA08414	KPA07914	KPA07915
KPA07922	KPA07923	KPA07924	KPA07932	KPA07935	KPA28489	KPA07916
KPA08411	KPA21041	KPA21043	KPA21035	KPA21036	KPA06366	KPA07936
KPA15414	KPA07125	KPA13182	KPA16194	KPA16193	KPA18217	KPA21202

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part E/Pjesa E/Deo E

KPA27332	KPA37434	KPA37450	KPA37451	KPA41085	KPA41086	KPA42229
KPA44362	KPA49288	KPA50482	KPA50483	KPA53968	KPA53972	KPA56581
KPA56587	KPA56588	KPA56589	KPA56592	KPA07060	KPA25525	KPA25526
KPA27333	KPA27334	KPA27344	KPA31985	KPA34744	KPA37438	KPA37439
KPA38548	KPA44449	KPA44452	KPA44596	KPA48781	KPA53663	KPA54212
KPA54236	KPA54426	KPA54427	KPA00563	KPA07051	KPA13787	KPA25678
KPA25681	KPA34740	KPA34741	KPA37429	KPA37446	KPA37447	KPA37448
KPA37449	KPA42224	KPA50631	KPA50633	KPA50634	KPA50638	KPA50639
KPA50640	KPA52069	KPA01439	KPA01441	KPA34356	KPA42270	KPA42274
KPA43048	KPA46014	KPA50578	KPA50580	KPA40956	KPA40957	KPA40961
KPA40962	KPA40964	KPA48784	KPA48788	KPA48789	KPA48790	KPA48791
KPA48792	KPA48793	KPA48794	KPA48795	KPA48796	KPA48797	KPA48798
KPA48799	KPA48929	KPA48930	KPA21152	KPA40959	KPA48785	KPA41445
KPA49738	KPA06225	KPA06240	KPA08664	KPA08663	KPA08665	KPA08667
KPA07122	KPA08654	KPA08656	KPA08657	KPA08661	KPA08662	KPA07056
KPA07069	KPA07072	KPA07074	KPA07077	KPA13261	KPA06643	KPA06646
KPA08870	KPA08867	KPA15851	KPA06429	KPA15970	KPA15974	KPA15977
KPA15962	KPA15966	KPA15955	KPA15965	KPA15956	KPA18425	KPA18420
KPA18421	KPA19391	KPA19392	KPA18467	KPA18435	KPA13596	KPA13595
KPA13594	KPA18423	KPA18072	KPA06119	KPA08737	KPA07053	KPA06649
KPA06642	KPA06637	KPA07059	KPA07062	KPA08739	KPA08536	KPA07054

KPA07066	KPA07063	KPA07068	KPA07379	KPA15967	KPA15968	KPA25664
KPA25152	KPA25669	KPA25143	KPA25667	KPA25146	KPA25671	KPA25153
KPA25150	KPA25141	KPA00601	KPA08659	KPA25209	KPA25207	KPA25204
KPA16028	KPA16027	KPA16026	KPA25210	KPA25203	KPA25211	KPA33565
KPA35863	KPA35860	KPA35872	KPA31585	KPA13416	KPA13409	KPA13423
KPA13406	KPA13424	KPA17065	KPA13690	KPA14360	KPA14354	KPA13685
KPA14353	KPA14359	KPA13691	KPA25148	KPA35858	KPA35850	KPA35518
KPA35513	KPA36657	KPA36658	KPA36662	KPA36663	KPA35871	KPA35869
KPA35868	KPA35866	KPA35864	KPA00579	KPA00574	KPA00530	KPA00551
KPA00577	KPA00584	KPA00583	KPA00586	KPA00556	KPA00609	KPA00588
KPA00552	KPA00578	KPA00569	KPA00585	KPA25145	KPA25149	KPA25147
KPA25668	KPA25151	KPA00549	KPA00572	KPA00550	KPA00576	KPA25666
KPA25672	KPA00545	KPA00589	KPA00593	KPA00543	KPA00587	KPA00533
KPA00582	KPA00597	KPA00598	KPA06126	KPA06125	KPA06121	KPA08808
KPA06134	KPA06138	KPA06137	KPA06127	KPA06122	KPA06124	KPA17054
KPA17046	KPA17051	KPA17050	KPA06135	KPA06139	KPA08809	KPA08934
KPA06128	KPA06129	KPA06131	KPA06133	KPA06136	KPA06132	KPA06123
KPA08741	KPA17049	KPA17048	KPA17047	KPA08729	KPA17053	KPA00581
KPA00539	KPA00529	KPA17052	KPA17044	KPA08735	KPA08732	KPA24198
KPA24226	KPA19001	KPA19379	KPA19378			